

Z. Qeram Cibaku ka kryer studimet e larta dhe është diplomuar si Financier i Lartë në vitin 1990. Gjatë periudhës 2002-2003 ka kryer Studimet Pasuniversitare për “Financë dhe banking” në Universitetin e Tiranës. Është certifikuar si Auditues i Brendshëm i Sektorit Publik në vitin 2005 dhe ka marrë licencën e përkohshme si Ekspert Kontabël i Autorizuar në Janar të vitit 1997.

Prej vitit 1998 deri në vitin 2006, z. Cibaku ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm në ministri të ndryshme (METE, MIE, etj.), kurse marrëdhëniet e punës me KLSH-në i ka filluar në vitin 2008 si Auditues i Lartë, Kryeauditues, Drejtor i Drejtorisë së Metodologjisë dhe Trajnimeve, Drejtor i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Aktualisht Z. Qeram Cibaku mban detyrën e “Kryeaudituesit” në Departamentin e Auditimit të Performancës.

Përgjatë karrierës së tij mbi 20 vjeçare si drejtues në njësitë e auditimit të brendshëm dhe si Auditues i Lartë në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Cibaku ka fituar një sërë kualifikimesh dhe certifikimesh nga institucione dhe organizata prestigjioze ndërkombëtare, përfshirë specializime dhe trajnime nga Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) Angli, Gjykata Europiane e Audituesve (ECA) Luksemburg, SIGMA, Banka Botërore, Qendra për Ekselencë në Financë (CEF) në Slloveni, Gjykata e Llogarive (Saystai) Turqi, Zyra e Auditimit Suprem të Polonisë (NIK), si dhe ka qenë pjesë e grupeve të punës dhe pjesëmarrës në konferenca të Organizatës Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI mbi implementimin e standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).